

---

## NEWSPAPER “Albania” - THE BEGGINING OF THE MODERN ALBANIAN JOURNALISM

**Albnora Musa**

University of Tetova, North Macedonia, [albnora.musa@unite.edu.mk](mailto:albnora.musa@unite.edu.mk)

**Abstract:** National propaganda in the period of the National Renaissance among Albanians was an important factor. The main objective was the effort that had to be made to awake and unite the Albanian nation and for the Albania of that time it was a vital need to continue its existence. Propaganda could be realized in different spheres and obviously the press could be ranked among the first. It played the role of one of the means of communication, information, recognition, appropriation and reflection of the objective reality, first of all of social and political life, but also in the direction of society and the state, actively influencing this process. However, knowing the continuous discriminatory policy of the Ottoman Empire towards national ideas and efforts among Albanians, the first organs of the Albanian press went outside the Albanian territories.

On the other hand, the Albanians, surrounded by Balkan enemies and having another Anatolian enemy in the interior of all of their territories, saw as their only hope how they would gain the help of the international factor, because until then they had been left alone, in the fight against enemies. In order to win the sympathy of a Great Power, there is no doubt that the Albanians should also raise their voices and stand out to the top international state governors. They should start and raise their voice demanding the rights like any other civilized nation, to have schools in their mother tongue, flourishing of its language, to develop the political life in the country and to prepare educated Albanians to use all of these as tools to achieve national rights. As a first-hand tool to achieve this goal, were seen all Albanians who lived far from the Albanian territories but who could contribute as educated people. Faik Konica, one of the most ardent patriot of the Albanian cause, was among the first to think that the establishment of a press authority would be done as a war against the enemies, a propaganda for development and a tool to protect their rights. He undertook to make the national awakening of the Albanians through “Albania” and for 12 years in row of its publication he realized such a thing. “Albania”, as an organ that wanted freedom, had the main goal to carry out propaganda for the Albanians to fight for freedom and to throw away the bars of slavery. “Albania” is presented with a special value as a flame that evokes love and the most powerful weapon to stand against the enemies of the Albanian nation.

Although with great difficulty, he managed to realize his several-year goal, the proclamation of a temporary one. He was not the first patriot to deal with the publication of newspapers, before him were a lot of others to take this step, but without question he will be the man who laid the pillars of modern Albanian journalism. His “Albania” made an indisputable contribution to the Albanian press, therefore March 25, 1897, the date when the first number of “Albania”, by Faik Konica, was published, marks the end of the first stage in the history of the Albanian press and the beginning of a new stage, that of the modern press, therefore the role of the newspaper “Albania” is indisputable in the Albanian press.

**Keywords:** Faik Konica, “Albania”, newspaper, journalism, propaganda etc.

## GAZETA “Albania” - FILLIMI I SHTYPIT MODERN SHQIPTAR

**Albnora Musa**

Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut, [albnora.musa@unite.edu.mk](mailto:albnora.musa@unite.edu.mk)

**Abstrakt:** Propaganda kombëtare në periudhën e Rilindjes Kombëtare tek shqiptarët ishte e një faktori të rëndësishëm. Detyra kryesore ishte përpjekja që duhej bërë për të zgjuar dhe bashkuar kombin shqiptar dhe për Shqipërinë e kohës së atëhershme ishte një nevojë jetësore për të vazhduar ekzistenca e saj. Propaganda mund të realizohej në sfera të ndryshme dhe padyshim shtypi mund të rradhitej ndër të parët. Ajo luante rolin e një prej mjeteve të komunikimit, informimit, të njohjes, përvetësimit dhe pasqyrimit të realitetit objektiv para së gjithash të jetës shoqërore, politike por edhe në drejtimin e shoqërisë dhe të shtetit duke ndikuar aktivisht në këtë proces. Mirëpo, duke ditur politikën e vazhdueshme diskriminuese të Perandorisë Osmane ndaj ideve dhe përpjekjeve kombëtare tek shqiptarët, organet e para të shtypit shqiptar dolën jashtë territoreve shqiptare.

Nga ana tjetër shqiptarët të rrethuar nga armiqtë ballkanik dhe duke pasur një armik tjetër anadollak në brendësi të të gjitha territoreve të tyre, si shpresë të vetme shikonin se si do e fitonin ndihmën e faktorit ndërkombëtar, kjo pasi deri në atë kohë kishin mbetur të vetëm në luftën kundër armiqve. Për të fituar simpatinë e ndonjë Fuqie të Madhe

padiskutim që edhe shqiptarët do duhej të ngrinin zërin e tyre dhe t'u binin në sy qeveritarëve të lartë shtetëror ndërkombëtar. Ata do duhej që të fillonin dhe të ngrinin zërin e tyre duke kërkuar të drejtat si çdo komb i qytetëruar, të kenë shkolla në gjuhë amtare, lulëzim të gjuhës së saj, të zhvillojë jetën politike në vend dhe të përgadiste shqiptarë të ditur për t'i përdorur të gjitha këto si mjete për të arritur të drejtat kombëtare. Si mjet i dorës së parë për të arritur këtë qëllim padiskutim që shiheshin edhe të gjithë shqiptarët të cilët jetonin larg territoreve shqiptare por që mund të kontriboshin si njerëz të ditur që ishin. Faik Konica njëri nga atdhetarët më të zjarrtë të çështjes shqiptare ishte ndër të parët që mendoi se themelimi i një organi të shtypit do të bëhej si një luftë kundër armiqve, një propagandë për zhvillim dhe mjet për të mbrojtur të drejtat e tyre. Ai mori përsipër që nëpërmjet “*Albania-s*”, të bëj zgjimin kombëtar tek shqiptarët dhe për 12 vite rrjesht të botimit të saj një gjë të tillë e realizoi. “*Albania*” si një organ që e dëshironte lirinë, qëllimin kryesor e kishte të realizonte propagandë që edhe shqiptarët të luftonin për liri dhe t'i hedhnin tutje hekurat e robërisë. “*Albania*” paraqitet me një vlerë të veçantë si një flakë që ngjall atdhe dashurinë dhe arma më e fuqishme për t'i qëndruar armiqve të kombit shqiptar.

Ndonëse me vështirësi të shumta, Faik Konica arriti që të realizonte synimin e tij disa vjeçar, shpalljen e një të përkohshme. Nuk ishte atdhetari i parë që u morr me botimin e gazetave pasi që kishte shumë para tij që bënë këtë hap por pa diskutim do të jetë ai personi që vendosi shtyllat e gazetarisë moderne shqiptare. “*Albania*” e tij dha kontributin e padiskutueshëm në shtypin shqiptar prandaj 25 marsi i vitit 1897, data kur doli nga shtypi numri i parë i “*Albania-s*”, së Faik Konicës, shënon fundin e etapës së parë të historisë së shtypit shqiptar dhe fillimin e një etape të re, ajo e shtypit modern, andaj roli i revistës “*Albania*”, është i padiskutueshëm në shtypin shqiptar.

**Fjalët kyçe:** Faik Konica, “*Albania*”, gazeta, shtypi, propaganda etj.

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare si pasojë e reaksionit të egër osman që ishte dhe të keqësimit të gjendjes ekonomike, mërgimi jashtë vendit e sidomos jashtë kufinjve të Perandorisë Osmane mori përmasa gjithnjë e më të mëdhaja. Qindra e mijra shqiptarë u detyruan të lënë vatrat e tyre dhe të mërgojnë në Rumani, Bullgari, Egjipt, dhe vende të tjera. Duke qenë se në atdheun e robëruar lëvizja kombëtare zhvillohej në kushte ilegale dhe zbatimi i programit të saj, qoftë për arsim dhe kulturë ishte gati e pamundur, një rëndësi gjithnjë e më të madhe mori veprimtaria e diasporës shqiptare. Veprimtaria atdhetare e shqiptarëve të mërguar organizohej dhe udhëhiqej nga disa shoqëri që ishin krijuar në atë kohë. Këto shoqëri ndonëse kishin synime të qarta politike i menjanonin ato si rezultat i *status quo*-së së vendosur nga Fuqitë e Mëdha, megjithatë atdhetarët shqiptar shfrytëzuan aspektet kulturore për të arritur realizimet në rrafshin politik (Historia e popullit shqiptar II, (2002).. Do të ishte pikërisht aspekti kulturor faktori kyç ai që do të çonte në vetëdijësimin kombëtar tek shqiptarët. Shtypi periodik i kohës ishte e një rëndësie gjithashtu parësore që do të realizonte një propagandë të rëndësishme për të plotësuar aspektet kulturore dhe politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ai i cili qe nismëtar i një rrugëtimi të gjatë, ndonëse në një moshë të thyer, ishte shkrimtari dhe atdhetari i shquar Jeronim de Rada i cili u bë nismëtar i një veprimtarie të madhe për popullin shqiptar. Në hapat e parë të fillimit të Rilindjes Kombëtare, në vitin 1848, në Napoli, Jeronim de Rada do të botonte gazetën e parë shqiptare “*Arbëreshi i Italisë*” (*L'Albanese d'Italia*). Ai nuk do ta kuptonte kurrë se bëri hapin e parë drejt një rrugëtimi të gjatë, me shumë sakrifica por, edhe me mjaft rezultate në rrafshin politik, arsimor, kulturor, gjuhësor por edhe më gjërë. Ata që do ta ndiqnin nga pas qenë edhe më të vendosur në punën e tyre për të krijuar shtyp sa më të zhvilluar shqiptar, si mjet që do të promovonte dhe mbronte çështjen shqiptare në ato kohë të vështira (Fevziu, B. (2005). Rrugën e tij e ndoqi edhe intelektual i ri shqiptar Faik Konica me gazetën e tij “*Albania*”, e cila botohej në një vend të Europës ku shqiptarët numëroheshin me gishta. Vepra monumentale e gjenit shqiptar do të botohet për rreth 12 vite me 126 numra gjithsej dhe padyshim në secilën shkronjë do të jetë zëri i të gjithë shqiptarëve në të gjitha fushat: politike, shoqërore, kulturore, gjuhësore, histori, gjeografi e sfera të ndryshme që vetëm një mendje e ndritur si Konica arriti që t'i gërshetojë në mënyrën më të mirë, ***të gjitha në një*** (Zelka, L. (2006).

Ideja për të kontribuar për kombin e tij i kishte lindur që herët, siç thekson edhe vet Konica, që në vitin 1890 kur ai kishte filluar me lëvrimin e gjuhës shqipe dhe kishte krijuar një bibliotekë që përmbante të gjitha librat e botuara prej albanologëve të huaj. Gjithashtu, kishte shkruar disa artikuj mbi kombësinë shqiptare në një gazetë të Parisit në momentet kur fatkeqësisht propaganda shqiptare nuk ishte formuar aspak, andaj mund të theksojmë që ishte Konica ndër të paktët që me iniciativë vetanake merreshte me të. Në këtë periudhë kohore vet Faik Konica dëshmon se ka qenë i prituri ftohtë nga disa dhe i pakuptuar nga disa të tjerë. Mirëpo ai ishte i vendosur në idenë e tij për të filluar një të përkoshme që lidheshte pikërisht me ngritjen e propagandës kombëtare tek shqiptarët (Andrea, F. 2016).

Marrë në konsideratë gjenialitetin e redaktorit pa diskutim që nuk mund të dyshohej se gazeta pati ndikim të madh në jetën politiko-atdhetare, kulturore dhe gjuhësore shqiptare. Ishte një ndërmarrje kolosale, me vlerë jo vetëm për kohën kur u botua dhe për historiografinë, por edhe për të ardhmen. Me bindjen më të plotë mund të themi se ajo vendosi gurthemet e gazetarisë shqiptare. Që nga dalja në dritë e numrit të parë, zëri i “*Albania-s*” dhe Konicës u vendosën në frontin më të lartë të mendjes shqiptare dhe nuk lëvizi më nga aty. Zëri i tyre tingëllonte në veshët dhe

mendjet e njerëzve me intervale herë më të shkurtra herë më të gjata (Ikonomi, I. 2017). Nuk ishte shumë e shpeshtë, ishte më e rrallë por kur vinte, vinte në formën e saj më të mirë plot hijeshi dhe freski. Ajo që e lartëson akoma edhe më shumë gazetën “Albania”, padiskutim që ishte edhe stili karakterizues që posedonte kryeredaktori i saj, që jo më kot mund të vlersohet si mendja më e ndritur e gjithë historisë letrare. Nëse dikush jepte punën ai jepte tonin. Ishte aristokrat i lindur. Sygjeri dhe drejtoi me nderime por ndodhte shpesh edhe kur nuk e kuptonin atëherë zemërohej, tallte ashpër, shante. Por edhe në momentet kur ofendonte e shante ishte aristokrat se dinte si t’i thoshte. I vetëdijshëm për aftësitë e tij, ai kishte fjalën që nuk u kursye t’a përdorte si armë, e ndoshta më keq akoma kur inatosej (Kamsi, W (2008).

E botuar për 12 vite rresht Faik Konica kishte menduar një ndarje mjaft interesante për gazetën. Ndarjen e gazetës nga viti i parë 1897 dhe deri në vitin 1904 e ndau me vëllime duke përdorur shkronja kurse nga viti 1905 e deri 1909 përdori numrat romak. Në vitin e parë, **Vëllimi A** numërimi bëhet me numra për secilin muaj dhe përfshihet periudha nga 25 marsi 1897 e deri në 30 prill 1898 dhe kishte gjithsej 12 numra. Numri i parë i saj do të kishte 16 faqe kurse deri në numrin e fundit e cila shkonte pa u ndalur në secilin numër arrin deri në 214 faqe gjithsej. Në vitin e dytë, **Vëllimi B** numërimi nuk bëhet me numra po ndahet si pasojë e muajve dhe përfshihet periudha nga 1-15 qershor 1898 deri në tetor-dhjetor 1898 dhe kishte gjithsej 10 numra. Numri i parë do të kishte gjithsej 20 faqe kurse numri i përgjithshëm i vitit të dytë do të ishte 164 faqe. Viti i tretë, **Vëllimi C** gjithashtu nuk kishte rradhitje të numrave por ishte e rradhitur sipas muajve dhe fillon nga 15-30 janari 1899 e deri në 15-30 shtator 1899 dhe kishte gjithsej 11 numra me 157 faqe. Në vazhdim të botimeve ndryshon vëllimi dhe kalon në **Vëllimin D** duke përfshirë dy numrat e ngelura nga viti 1899 dhe më pas kalon tek viti 1900. Në vëllimin D fillon me dy numra të 10 dhe 11 nga vëllimi paraprak dhe vazhdon me 7 numra të tjerë të vitit 1900. Edhe pse ka ndryshime në vite numërimi i faqeve mbetet i njëjti deri në fund të gazetës kështu që ky vëllim numëronte gjithsej 144 faqe. Në numrin e ardhshëm **Vëllimi E** përfshin periudhën e 10 shtatorit deri në 31 dhjetor të vitit 1900 dhe fillon nga numri i 8 i mbetur nga vëllimi paraprak dhe gjithsej përfshinte 5 numra, duke përfshirë këtu se në dhjetor ishte botuar dy herë, njëherë në 15 dhe tjetri në 31 dhjetor. Numri i faqeve të katër numrave të parë ishte 80 kurse numri i fundit u numërua veçmas dhe kishte 16 faqe. Në vitin 1901 gazeta “Albania” emërohej me **Vëllimin F** e cila përfshinte periudhën nga 31 kalëndori (janari) e deri në 15 dhjetor 1901 dhe kishte gjithsej 12 numra dhe përfshinte gjithsej 200 faqe. Viti 1902 i takonte **Vëllimi G** dhe kishte gjithsej 11 numra duke përfshirë periudhën nga janari e deri në dhjetor të vitit 1902 dhe kishte gjithsej 263 faqe. **Vëllimi H** ishte botimi i vitit 1903 dhe përfshinte gjithsej 12 numra nga Kalënduari e deri në dhjetuar me gjithsej 192 faqe. Në botimin e vitit 1904 ose në botimin e fundit që përdorte vëllime, respektivisht **Vëllimi I** kishte një ndryshim pasi që shënoheshin numrat e gazetës por nuk shënoheshin më muajt. Kështu që ky vëllim kishte gjithsej 11 numra me 216 faqe. Në vitin 1905 ndryshon në pamje gazeta “Albania” e cila tashmë nuk përdor shkronjat dhe në vend që të vazhdonte të shënonte Vëllimin J ai fillon përdorimin e numrave romak. Ky botim tashmë emërohej si **Vëllimi IX** dhe kishte gjithsej 12 numra me gjithsej 240 faqe. E njëjta procedurë përdorej edhe në vitin 1906 i emëruar vetëm si **Vëllimi X** dhe përdoren numrat por nuk shënoheshin muajt dhe kishte gjithsej 228 faqe. Viti 1907 apo i emëruar si **Vëllimi XI** paraqitet si viti problematik i gazetës pasi që përveç se përfshin dy vite në të njëjtin vëllim, vitin 1907 dhe 1908 ajo ka gjithsej 5 numra me gjithsej 124 faqe. Viti i fundit i botimit viti 1909 do të ishte **Vëllimi XII** dhe kishte në përbërje vetëm një numër me 48 faqe dhe me këtë mbyllet gazeta e pa paralajmëruar (Albania 1897-1909).

Në asnjë moment Faik Konica nuk e bëri të qartë se nuk do vazhdonte që t’a botonte më gazetën. Kur kishte mbyllur vëllimin e njëmbëdhjetë për shkaqe teknike ai premtoi që do e fillojë tjetrin me rradhë, të dymbëdhjetin, me një bazë të re, duke e lartësuar dhe duke e përmirësuar edhe më shumë (Albania, 1907). Ai gjithashtu theksonte, se nga ai numër botimet do të dalin me rradhë dhe shpresonte se edhe atdhetarët e tjerë do të jepnin kontributin e tij dhe do të kënaqeshin duke e lexuar. Fatkeqësisht një gjë e tillë nuk ndodhi pasi që menjëherë pasi Faik Konica premtoi këtë boton edhe një numër edhe e përmbyll veprimtarinë me “Albania-n” e tij, pergamenën shqiptare.

Një gazetë e kompletuar qoftë nga përmbajtja e mbrendshme e saj qoftë edhe nga detajet që kishte zgjedhur kryeredaktori për kopertinën, cilësinë, madhësinë e gazetës. Si për shumë çështje tjera edhe në lidhje me programin e saj, “Albania” do të ishte shumë origjinale. Ndihej në punën e redaksive të revistave dhe gazetave për përcaktimin e programit, misionit dhe qëllimin e organeve të tyre të shtypit. Përsa i takon politikës redaksionale bie në sy qëndrimi demokratik ku secili ka qenë i lirë të shprehej si ia pret mendja, ndërsa redaksia nuk ka pasur asnjë të drejtë të mos shtypte artikuj që nuk ishin pas mendjes së saj. Kontributi i “Albania-s” është edhe në hapat e parë të lëvrimin të gjuhës së njësuar letrare shqipe, të publicistikës e gazetarisë, ku dallohej stili i rrallë dhe shprehjet e begata të drejtorit të saj, Konica. Ishte habitëse rrjedhshmëria e gjuhës shqipe e përdorur nga redaktori i saj i cili as nuk jetonte në Shqipëri dhe që ishte larguar nga aty vite më parë. Ai ishte larguar nga vendi i tij dhe familja e tij e cila shquhej në Konicë me të ardhura relativisht të mira. Megjithatë, i shtyrë nga dashuria e mësimin, ai ndonëse shumë i ri, la gjithçka pas dhe siç e thoshte edhe vet: *kjo ishte një fund në vete*, shkroi fatin e tij dhe duke u bërë i zoti i vetes me të hollat e tij. Duke ndjekur nga pas ëndrrën e tij për tu plotësuar me ide dhe mendime përparimtare

të kohës që ai i mendonte atëherë, botëkuptimin perëndimor dhe larg atij oriental, që e kishte kapluar që sa e sa vite vendlindjen e tij, Shqipërinë. Gjuhën që ai përdori u bë model për shumë atdhetarë më pas, jo vetëm për ata të cilët bashkëpunonin me gazetën “Albania” por edhe për të tjerët (Andrea, F (2016).

Përvoja që mori në një nga qendrat e civilizimit evropian, në Francë bëri që gazetës të mos i mungojë asgjë dhe ajo të ishte në rradhë me gazetatat botërore të kohës. Duke pasur parasysh faktin se gazeta botohej në Bruksel, Konica përdori krahas gjuhës shqipe në të dy dialektet në gegërisht dhe toskërisht, edhe gjuhën frënge dhe osmane. Faik Konica hartoi gazetën në këtë mënyrë që përveç se të ishte një udhërrëfyese e mirë e shqiptarëve ajo t’i shërbejë edhe popujve të tjerë e sidomos popujve që kuptonin gjuhën frënge. Kjo për arsye që ato të mësonin diçka të dorës së parë për shqiptarët dhe jo nga të tjerët që shkruanin për to. Faik Konica që në dalje të numrit të parë pra 25 marsi i 1897 e deri në numrin e fundit kishte në kopertinë mesazhin e qartë, *këtu do të lëvrohet çdo gjë kombëtare*. Gazeta ishte e menduar mirë dhe bënte pjesë në mesin e gazetave më të mira të kohës, ajo që binte në sy çdoherë ishte titulli i gazetës me shkronja kapitale ALBANIA kurse çdo gjë tjetër që ishte e shkruar ishte në të dy gjuhë, shqipe dhe frënge. Sa i përket teknikës së përdorimit në gazetë ajo kishte një format prej 21,7 me 16.5 si dhe me një kopertinë bukur mirë të menduar. Si realizues mjeshtërisht i ideve të Faik Konicës në realizimin e kopertinës “Albania”, paraqitet miku i tij, Paul Nocquet (Albania 1898). Një artist që punonte me mjeshtëri gurin dhe gëzonte një reputacion në Belgjikë. Për mjeshturinë e tij na jep informacion Konica duke na treguar që Nocquet arrin që të realizojë edhe fytyra njeriu mbi gur kurse sa i përket miqësisë së afërt mes këtyre të dyve flet edhe për qëllimin e mjeshtrit belg i cili ka dashur të vizitohet Shqipërinë e Konicës. Kopertina e “Albania-s” pas disa botimeve do ndryshohej për të sjellë risi për lexuesin dhe kopertina e re që do të realizohej, Konica i’a kishte besuar një tjetër mikut të tij, Alfred Bastien i cili po ashtu paraqitet si një nga piktorët më të njohur belg (Albania 1898.). Kurse sa i përket materialit të përdorur padyshim që ishte e një cilësie të mirë por vlen të theksohet se në vitin 1907 Faik Konica ndryshon edhe materialin e përdorur në gazetë. Nga viti i parë deri në 1907 ai përdor material të mirë të drurit, kurse më vonë ai përdor një material lecke që ishte i bukur dhe i kushtueshëm (Albania, 1907).

Të gjitha kopertinat e përdorura në gazetë në vetvete japin mesazhe të thella ashtu siç vetëm Konica mundi të bënte një lidhje të tillë. Në kopertinën e parë e cila u përdor nga numri i parë e deri në numrin e dhjetë të botimit të tij më 1899 ishte vendosur një djal i veshur me rroba kombëtare. Faik Konica ndoshta ka dashur të jap mesazhin e qartë botës që në të parë të gazetës secili nga individët të kuptonte diçka për historinë e tij kombëtare. Bujku që paraqitet në kopertinë ka si kryefjalë mbjelljen e farës së mirë në tokë, si mëmëdhetar i vërtetë mbjell qëllimin e shenjtëruar në mendje të vëllezërve të tij. Trimi malësor ka në të dy duart e tij gjërat që do të shpëtonin Shqipërinë, në njërën dorë kishte armën dhe në tjetrën librin. Me këtë Konica dëshironte të jap mesazhin që shqiptarët duhet të luftojnë për të drejtat e tyre kombëtare kur është nevoja edhe me armë. Në dorën tjetër kishte librin e hapur që jep mesazhin që shqiptarët duhet t’i kthehen shkollimit të tyre për të ngritur vetëdijen e tyre kombëtare dhe me këtë të bëhen zotër të drejtave të tyre. Nuk kishte si të mungonte as edhe simboli identifikues i shqiptarëve, figura madhore e Skëndërbeut e dhënë më tepër në ngjyrë të verdhë që sipas gjasave na jep mesazhin e rrezeve të diellit që edhe për Shqipërinë do të lindte një ditë (Albania, 1897).

Duke ditur karakterin e Faik Konicës një njeri kërkues që anonte drejt perfeksionimit ai shkonte çdoherë ndaj risive dhe duke u përmirësuar. Në vitin e parë të botimit u vendos që gazeta të botohej një herë në muaj kjo pasi që ai preferonte të shkruaj 32 kolona të menjëhershme dhe jo 16 kolona te ndara në dy muaj. Kjo pasi që sipas tij nuk do të arrinte të botonte artikuj të gjatë ku do të mund t’i shpaloste të gjitha të ligat e armiqve të Shqipërisë gjë që në artikujt e shkurtër nuk do të arrinte që t’a realizonte ashtu si ai dëshironte. Mirëpo duke parë se gazeta u prit mirë dhe lexuesit mezi prisnin t’a kishin në duart e tyre, duke pasur lexueshmëri të lartë mendoj që të shtojë numrin e kolonave dhe t’a botonte më shpesh. Këtë informacion ai e jep në botimin e muajit nga 1 deri në 15 qershor kur Faik Konica bënte me dije që gazeta do të dal në botim dy herë në muaj, edhe atë më 2 dhe 17 të çdo muaji (Albania 1898). Kurse në numrat pasues do të shkruante se ai kërkonte diçka tjetër për të tërhequr akoma dhe më shumë vëmendjen e lexuesve. Vëmendjen e lexuesve u mundua që t’a bënte më evidente në punën e tij me anë të ndryshimit të kopertinës.

Në vitin 1899 ai e ndryshon kopertinën që si zakonisht titulli i saj do të vendosej në qendër tashmë dhe si shtesë do shënohej edhe “*E përkoreshme shqip Del dy herë në muaj. U themelua më 1896*”, në anën e majtë në gjuhën shqipe dhe në anën e djathtë në gjuhën frënge. Që në kopertinë gazeta përsëri shpalos qëllimin e saj se do të ishte si një analizë e përgjithshme e historisë kombëtare shqiptare, fillimisht për të mbrojtur territoret e tyre dhe përparimin e popullit deri tek akti më i rëndësishëm kombëtar, shteti i tyre i pavarur. “*Të mbahet e të ritet kombësia. Të lerohet e të zbukurohet Gjuha se Gjuha është shënimi i kombësisë. të Përmirsohet gjendja e Popullit, se, kur është i pasur Populli, Kombësia mbahet e tëra, e fortë, e e lirë*”, shkruante më tej Faik Konica. Edhe këtë mesazh ai e bën në dy gjuhë përsëri në anën e majtë në gjuhën shqipe dhe në anën e djathtë në gjuhën frënge. Edhe këtë herë ajo që binte në sy do të ishte simboli kyç i kopertinës së gazetës dhe për këtë gjë Konica kishte zgjedhur shqiponjën dy krahëshe e stolisur mbi koka me një vazë ku dilnin gjashtë flaka të zjarrit. Menjëherë poshtë vazës shkruhej fjala latine

UNITAS që me shumë gjasë, Konica na jep mesazhin e qartë se dëshironte bashkimin e shqiptarëve, duke ditur diferencat e shumta që ekzistonin mes tyre në atë kohë. Në anën e majtë shkruhej fjala ANNO kurse në të djathtë viti 1896 që na tregon edhe në skemë vitin që kur daton gazeta pasi që në mes të tyre qëndron pikërisht fjala ALBANIA. Faik Konica nuk harron që të jap mesazhin edhe të një aspekti tjetër që ishte ndaras për shqiptarët pikërisht aspekti fetar, ku përsëri në kopertinë kishte vendosur edhe kryqin edhe gjysmë hënën me yllin. Në fund të skemës kemi një shirit që bashkon këmbët e shqiptonjës në të cilën shkruhet UNGUIBUS ET ROSTRIS fjalë edhe kjo latine që do me thënë *me qipë e me thonjë* që Faik Konica me anë të këtij mbishkrimi bën me dije se bijtë e shqiptonjave do të luftonin me qipë e me thonjë për të arritur bashkimin e tyre pavarësisht të gjithë diferencave për realizimin e një Shqipërie të pavarur (Albania 1904). Këto dhe shume arsye të tjera bën që kjo gazetë sëbashku me redaktorin e saj të vendosin shtyllat e gazetarisë moderne shqiptare. “Albania” e Konicës dha kontributin e padiskutueshëm në shtypin shqiptar prandaj 25 marsi i vitit 1897, data kur doli nga botimi numri i parë i “Albanias”, së Faik Konicës, shënon fundin e etapës së parë të historisë së shtypit shqiptar dhe fillimin e një etapë të re, ajo e shtypit modern (Fevziu, B. 2006), andaj roli i revistës “Albania”, është i padiskutueshëm në historinë kombëtare dhe në shtypin shqiptar.

### PËRFUNDIMI

Propaganda kombëtare në periudhën e Rilindjes Kombëtare tek shqiptarët ishte e një faktori të rëndësishëm. Detyra kryesore e saj ishte përpjekja që duhej bërë për të zgjuar dhe bashkuar kombin shqiptar. Shtypi në këtë periudhë luajti rolin parësor duke i dhënë shtysë veprimtarive kombëtare tek shqiptarët. E një roli të veçantë ishte gazeta “Albania” e krijuar nga Faik Konica më 25 mars 1897 e cila për 12 vite rrjesht të botimit të saj si synim kishte të bënte zgjimin kombëtar tek shqiptarët dhe një gjë të tillë e realizoi. “Albania” si një organ që e dëshironte lirinë, qëllimin kryesor e kishte të realizonte propagandë që edhe shqiptarët të luftonin për liri dhe t’i hedhnin tutje hekurat e robërisë. “Albania” paraqitet me një vlerë të veçantë si një flakë që ngjall atdhe dashurinë dhe arma më e fuqishme për t’i qëndruar armiqve të kombit shqiptar. Shkronjat, ortografia, të vendosurit e një gjuhe letrare, të mbajturit e tërësisë së atdheut, mjetet për të përparuar kombi, sheshimi i kundërthënieve fetare dhe lokale, shpëtimi i krizës ekonomike, të gjitha këto por dhe më shumë do të zënë vend në “Albania”. Duke marrë parasysh diapazonin e gjërë të trajtimit të temave të ndryshme dhe mënyrën e realizimit të gazetës nga brendësia e saj mund të konkludojmë se Faik Konica nuk ishte i pari që u mor me gazetari në Shqipëri por padyshim që vendosi standarte të reja të një niveli të jashtëm perëndimor andaj mund të themi me bindje se gazeta “Albania” është fillimi i shtypit modern shqiptar.

### BIBLIOGRAFIA

- Gazeta “Albania” 1897, A, f. 1.  
Gazeta “Albania” 1898, C, Nga 15 gjer në 30 të shkurtit. C, f. 23.  
Gazeta “Albania” 1898, B, Nga I gjer në 15 të qershorit. B, f. 10, 13.  
Gazeta “Albania”, 1904, Viti i 8, Nr. 9. I, f. 181.  
Gazeta “Albania”, 1907, Viti i 11, Nr. 2, f. 29.  
Gazeta “Albania”, 1907, Viti 11, Nr.5, f. 114.  
Andrea, F. (2016). *Faik Konica-Përlindësi modern*. Tiranë: Zenit.  
Fevziu, B. (1996). *Historia e shtypit shqiptar*. Tiranë: Marin Barleti.  
*Historia e Popullit Shqiptar II-Rilindja Kombëtare-vitet e 30 të shek. XIX-1912*. 2002. Tiranë: Toena, f. 240, 343.  
Ikonomi, I. (2017). *Faik Konica Jeta në Uashington*. Tiranë: UETPress.  
Jorgaqi, N. (2004). *Antalogji e Faik Konicës*. Tiranë: Albas, f. 144-145.  
Kamsi, W. (2008). *Albania 1897-1909, Bibliografi kronologjike*. Shkodër: Botime Françeskane.  
Përnaska, R., & Plangarica, T. (2017). *Faik Konica në zanafillat e teorisë së përgjithshme të përkthimit*. Në *Albanologji 7*. Prishtinë: Instituti Albanologjik.  
Pirraku, M. (1995). *Albania e Konicës*. Prishtinë: Timegate.  
Shkodra, Sh. (1995). *Albania e Konicës pergamenë shqiptare*. Prishtinë: Rilindja, f. 22.  
Zelka, L. (2006). *Mendimi për gazetarinë shqiptare*. Tiranë: Globus R, f. 31, 34, 35.